



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 21 dhjetor 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: nëntor 2021

- Në nëntor 2021, **paraaja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})** u rrit për 0,7% në bazë mujore, kryesisht si rezultat i rritjes së parave depozituese, dhe me rritje më të ulët edhe te depozitat afatshkurtra, si dhe në kushte të rënies së parave të gatshmenë qarkullim dhe depozitave afatgjata deri në dy vjet. Në bazë vjetore, oferta monetare u rrit për 9,5%, kryesisht si pasojë e rritjes së depozitave të parave dhe depozitave afatshkurtra, në kushtet e rritjes më të vogël të parave të gatshme në qarkullim dhe depozitave afatgjata pothuajse të pandryshuara deri në dy vjet.

Tabela 1. Totali i depozitave dhe kredive³⁴ të sektorit joqeveritar

	sostojba (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	10.2021	11.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	10.2021	11.2021	10.2021	11.2021
Парична маса M4	455,834	468,912	469,050	486,989	505,157	507,914	8.9	9.8	6.9	6.9	7.8	7.6	-0.5	0.5
Парична маса M3	403,714	416,935	418,556	436,231	458,578	461,572	8.3	9.7	7.6	8.0	9.7	9.5	-0.5	0.7
<i>од кои:</i>														
Готови пари во оптик	37,891	41,125	41,667	43,701	44,699	42,817	21.3	26.3	24.9	21.0	6.6	3.6	-0.6	-4.2
Вкупни депозити	409,200	418,916	418,644	434,915	451,580	456,329	8.3	8.4	6.1	5.9	8.1	8.1	-0.4	1.1
<i>од кои:</i>														
Корпоративен сектор	108,138	110,550	112,505	123,212	127,992	132,332	12.5	11.2	8.0	10.1	13.9	13.7	-1.6	3.4
Во денари	75,876	77,609	79,641	86,323	85,602	89,584	13.8	9.3	5.4	5.4	8.8	10.5	-2.1	4.7
Во странска valuta	32,261	32,941	32,865	36,889	42,390	42,748	9.5	15.9	14.9	22.8	25.9	20.9	-0.6	0.8
Домаќинства	275,574	280,512	278,469	285,216	297,787	298,786	8.6	8.7	6.1	4.6	7.2	7.1	0.0	0.3
Во денари	147,532	149,204	145,806	150,991	150,463	148,093	11.9	10.1	6.2	3.3	4.0	1.9	-2.3	-1.6
Во странска valuta	128,042	131,309	132,663	134,225	147,324	150,693	5.1	7.1	6.0	6.2	10.7	12.9	2.6	2.3
Вкупни кредити	343,702	352,718	352,824	357,296	377,466	380,475	5.8	6.6	7.3	4.7	6.7	7.7	0.6	0.8
<i>од кои:</i>														
Корпоративен сектор	167,654	172,978	168,086	169,826	177,363	179,052	1.8	4.6	5.2	1.1	5.6	7.4	0.7	1.0
Во денари	103,597	106,688	101,925	102,688	109,049	110,678	0.4	3.3	2.7	-0.9	6.7	9.8	1.5	1.5
Во странска valuta	64,057	66,290	66,161	67,138	68,314	68,375	4.0	6.9	9.3	4.3	4.1	3.8	-0.4	0.1
Домаќинства	174,634	178,384	183,431	185,814	198,190	199,357	10.1	8.8	9.5	8.0	7.3	7.7	0.5	0.6
Во денари	96,643	99,469	103,939	105,049	112,216	113,009	8.8	8.7	12.0	10.5	6.9	7.5	0.7	0.7
Во странска valuta	77,990	78,916	79,492	80,765	85,974	86,348	11.9	8.9	6.4	5.0	7.9	7.9	0.4	0.4

Burimi: BPRMV.

¹ Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si një përkufizim i ri standard për paranë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetare M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

² Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (paraaja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjija/Metodologjija_monetarna_07_2018_mak.pdf

³ Normat vjetore të kredive në periudhën nga korriku 2019 këndej janë nën ndikimin e efekteve nga masat e BPRMV-së për fshirjen e kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit.


⁴ Të dhënat për agregatet monetare, si dhe totali i depozitave dhe kredive deri në gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelim dhe punë dhe për të cilën është iniciuar një procedurë falimentimi.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në muajin nëntor, **depozitat⁵ totale** shënuan rritje mujore prej 1,1%, e cila në masë më të madhe erdhi si pasojë e rritjes së depozitave të sektorit të korporatave. Rritja vjetore e totalit të depozitave është 8.1% dhe është rezultat i rritjes së depozitave në të dy sektorët, me kontribut më të madh të sektorit "amvisër".

- **Totali i kredive⁶**, këtë muaj, shënoi rritje për 0,8% në bazë mujore, ndikuar nga rritja e kredive në të dy sektorët, me një kontribut më të madh të sektorit të korporatave. Në bazë vjetore, kredite totale shënuan rritje prej 7,7%, e cila në kushtet e rritjes së kredive në të dy sektorët, ishte më e theksuar në sektorin "amvisër".



Burimi: BPRMV

1. Depozitat dhe kredite të sektorit të korporatave⁷



Burimi: BPRMV

⁵ Totalin e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetare M4

⁶ Më 9 gusht të vitit 2018, Këshilli i Bankës Popullore e miratoi Vendimin mbi metodologjinë për administrimin e rrezikut të kredisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 149/18), sipas së cilës bankat janë të detyruara t’i transferojnë nga evidenca e bilancit në evidencë jashtë bilancit (dhe të vazhdojnë me transferimin e) të gjithë kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit. Vendimi për metodologjinë e administrimit të rrezikut të kredisë filloi të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2019, duke shterur kështu efektin e bazës së krahasimit në korrik të vitit 2020. Prandaj, ndryshimet në normat vjetore të ndryshimit të kredive me dhe pa efektin e fshirjeve të kryera janë të parëndësishme, për shkak të së cilës nga njoftimi i muajit gusht këndej këto krahasime janë ndërprerë.

⁷ Për qëllimet e këtij njoftimi, sektori i korporatës përfshin kompani publike dhe private jofinanciare




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Totali i depozitave të sektorit të korporatave** në muajin nëntor shënoi rritje për 3,4% në bazë mujore. Rritja mujore është kryesisht për shkak të rritjes së parave depozituese, në kushte të rritjes më të ulët dhe të depozitave afatgjata dhe afatshkurtra në valutë të huaj, gjatë rënies së depozitave afatgjata dhe afatshkurtra në denarë. Krahasuar në bazë vjetore, këto depozita janë më të larta për 13,7%, si pasojë e rritjes së parave depozituese, depozitave afatshkurtra dhe afatgjata në valutë të huaj, gjatë rënies së depozitave afatshkurtra dhe afatgjata në denarë.
- Në muajin nëntor, **kreditë totale të sektorit të korporatave**⁸ shënuan rritje mujore prej 1,0%, që më së shumti është rezultat i rritjes së kreditimit në denarë. Krahasuar me nëntorin e vitit paraprak, kreditë për sektorin e korporatave janë rritur për 7,4%, si rezultat i rritjes së kredive në denarë dhe në valutë të huaj, me një kontribut më të madh të kredive në denarë.



Burimi: BPRMV

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive⁹



Burimi: BPRMV


⁸ Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.

⁹ Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe personave të vetëpunësuar




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Totali i **depozitave të amvisërive**, këtë muaj, shënuan rritje prej 0,3% në bazë mujore. Ndryshimi kryesisht vjen si pasojë e rritjes së depozitave afatshkurtra në valutë të huaj, me rritje më të ulët dhe depozitave afatgjata në valutë të huaj, ndërsa paratë depozituese, depozitat afatshkurtra dhe afatgjata në denarë shënuan rënie. Në bazë vjetore, këto depozita rezultuan më të larta për 7,1%, më së shumti si pasojë e rritjes së depozitave afatshkurtra dhe parave në valutë të huaj, me rritje më të ulët të depozitave afatgjata në valutë të huaj, si dhe në kushtetë rënies së depozitave afatgjata dhe afatshkurtra në denarë.
- Në muajin nëntor, **kreditë për amvisëri** janë rritur për 0,6% në bazë mujore, me rritje vjetore prej 7,7%. Në kushtet e rritjes së kredive në denarë dhe në valutë të huaj, rritja në baza mujore dhe vjetore është më e theksuar tek kreditë në denarë.



Burimi: BPRMV



Burimi: BPRMV



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Tabela 2. Kredi të bankave dhe shtëpive të kursimeve të dhëna personave fizikë, sipas qëllimit

	sostojba (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	10.2021	11.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	10.2021	11.2021	10.2021	11.2021
Потрошувачки кредити	93,440	94,982	97,850	98,772	104,384	104,956	13.5	10.0	9.9	6.9	6.3	6.8	0.5	0.5
Станбени кредити	52,959	54,392	55,985	58,306	65,648	66,443	13.9	13.8	14.0	13.6	16.0	16.1	1.0	1.2
Автомобилски кредити	306	292	291	282	243	238	-4.1	-8.6	-7.9	-10.9	-14.1	-17.9	0.7	-2.4
Кредитни картички	11,570	11,508	11,649	11,205	10,330	10,337	-4.5	-4.2	-2.6	-6.1	-10.8	-9.3	-0.5	0.1
Негативни салда по тековни сметки	6,499	6,205	6,280	5,818	6,570	6,537	-4.8	-9.4	-10.8	-5.0	1.3	1.2	1.5	-0.5
Други кредити	3,969	3,946	3,912	3,871	2,729	2,680	-6.7	-6.4	-6.7	-6.0	-29.8	-30.6	-1.3	-1.8

Burimi: BPRMV.

- Në muajin nëntor, sipas qëllimit të kredive të miratuara për persona fizik, **kreditë konsumatore dhe kreditë për strehim**, si kategori më e zakonshme, shënuan rritje mujore prej 0,5% dhe 1,2%, përkatësisht, me rritje vjetore prej 6,8% dhe 16,1%. Këtë muaj, **kreditë për automjete** shënuan rënie prej 2,4% dhe 17,9% në bazë mujore dhe vjetore, ndërsa kreditë e miratuara me **kartela kreditore** shënuan rritje minimale mujore prej 0,1%, me një rënie vjetore prej 9,3%. **Bilancet negative në logaritë rrjedhëse**, janë më të ulëta për 0,5% në bazë mujore, ndërsa në bazë vjetore janë rritur për 1,2%. Në muajin nëntor, kreditë e miratuara në **baza tjera** shënuan rënie mujore dhe vjetore prej 1,8% dhe 30,6%, përkatësisht.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Bilance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika.nsp

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_monetarna_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimi të të dhënave:

http://nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 21 janar të vitit 2021 (mesatare referuese me dhjetorin 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit. Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 110/108).